



**UDHËZUES  
PËR GAZETARËT  
DHE AKTIVISTËT  
MBI MONITORIMIN  
E PERFORMANCËS  
SË BASHKIVE**

Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
And Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



**HELVETAS**

Çdo riprodhim ose përdorim i përmbajtjes nga ky botim duhet të citojë burimin origjinal.

Ky manual është prodhuar nga Faktoje përmes mbështetjes së projektit Bashki të Forta, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së Suedisë, dhe zbatuar nga Helvetas.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Qendrës Faktoje, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së, Qeverisë Zvicerane apo Qeverisë së Suedisë.

Autor: Erjon Tase

# PËRMBAJTJA

<b>Hyrje</b> .....	5
<b>Qëllimi i manualit</b> .....	6
<b>Kuadri i performancës vendore</b> .....	7
<b>Promovimi i praktikave të mira</b> .....	8
<b>Praktika 1.</b> Rritja e të ardhurave të veta për frymë.....	8
<b>Praktika 2.</b> Ulja drastike e detyrimeve të prapambetura.....	8
<b>Praktika 3.</b> Rritja e investimeve për frymë.....	9
<b>Praktika 4.</b> Përmirësim i arsimit parashkollor.....	9
<b>Praktika 5.</b> Rritja e funksionalitetit të sistemit ujitës-kullues.....	9
<b>Praktika 6.</b> Rritja e kapaciteteve të mbrojtjes nga zjarri.....	10
<b>Praktika 7.</b> Përmirësim i menaxhimit të mbetjeve.....	10
<b>Praktika 8.</b> Rritje e shpejtësisë së reagimit në shërbimet sociale.....	10
<b>Praktika 9.</b> Rritje e transparencës dhe qeverisjes së hapur.....	11
<b>Praktika 10.</b> Integrimi evropian në nivel bashkie.....	11
<b>Metodologjia e monitorimit</b> .....	12
<b>Hapi 1.</b> Përcakto pyetjen hulumtuese.....	12
<b>Hapi 2.</b> Mblidh të dhënat.....	13
<b>Hapi 3.</b> Analizo.....	13
<b>Hapi 4.</b> Verifiko.....	13
<b>Hapi 5.</b> Raporto qartë.....	14
<b>Gazetaria hulumtuese vendore</b> .....	15
<b>Hapi 1.</b> Si të identifikosh një histori të fortë.....	16
<b>Hapi 2.</b> Si të strukturosh një investigim.....	16
<b>Hapi 3.</b> Etika dhe siguria.....	16
<b>Mjetet praktike për OSHC-të</b> .....	17
<b>Hapi 1.</b> Monitorim i shërbimeve publike.....	17
<b>Hapi 2.</b> Advokim i bazuar në prova.....	17
<b>Formate të gatshme për informim</b> .....	18
<b>Formati 1.</b> Kërkesë për Informacion.....	18
<b>Formati 2.</b> Raport Monitorimi.....	19
<b>Formati 3.</b> Artikull Investigativ.....	20
<b>Formati 4.</b> Policy Brief për Vendimmarrësit.....	21
<b>Lista e kontrollit</b> .....	22

<b>Referenca</b> .....	23
<b>Shtojcë</b> .....	24
<b>Kategoria 1. Shërbimet</b> .....	24
<b>Fusha 1.</b> Arsimi Parauniversitar .....	24
<b>Fusha 2.</b> Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit .....	25
<b>Fusha 3.</b> Pyjet dhe Kullotat .....	25
<b>Fusha 4.</b> Mbrojtja nga Zjarri (MZSH) .....	26
<b>Fusha 5.</b> Menaxhimi i Mbetjeve (MIM).....	26
<b>Fusha 6.</b> Mbrojtja Sociale .....	27
<b>Fusha 7.</b> Arsimi parauniversitar.....	27
<b>Fusha 8.</b> Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....	29
<b>Fusha 9.</b> Pyjet dhe kullotat.....	29
<b>Fusha 10.</b> Mbrojtja nga zjarri (mzsh) .....	30
<b>Fusha 11.</b> Menaxhimi i mbetjeve (mim).....	31
<b>Fusha 12.</b> Mbrojtja sociale.....	32
<b>Kategoria 2. Mirëqeverisja</b> .....	33
<b>Fusha 1.</b> Burimet Njerëzore .....	33
<b>Fusha 2.</b> Transparenca dhe Llogaridhënia .....	34
<b>Fusha 3.</b> Barazia Gjinore (BGJ) .....	34
<b>Fusha 4.</b> Integrimi në Bashkimin Evropian .....	35
<b>Fusha 5.</b> Burimet njerëzore .....	35
<b>Fusha 6.</b> Transparenca dhe llogaridhënia.....	36
<b>Fusha 7.</b> Barazia gjinore.....	37
<b>Fusha 8.</b> Integrimi në bashkimin evropian .....	38
<b>Kategoria 3. Menaxhimi financiar</b> .....	39
<b>Fusha 1.</b> Të ardhurat .....	39
<b>Fusha 2.</b> Buxheti .....	40
<b>Fusha 3.</b> Shpenzime .....	40
<b>Fusha 4.</b> Të ardhurat .....	40
<b>Fusha 5.</b> Buxheti .....	41
<b>Fusha 6.</b> Shpenzime .....	41

## HYRJE

Qeverisja vendore është një nga shtyllat kryesore të funksionimit demokratik. Ajo prek drejtpërdrejt jetën e qytetarëve përmes shërbimeve të përditshme: pastrimit, ndriçimit, ujësjellësit, arsimit parashkollor, shërbimeve sociale dhe shumë të tjerave. Për këtë arsye, monitorimi i performancës së bashkive është një proces thelbësor për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Ky manual është hartuar për të mbështetur gazetarët, aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile që duan të ndërtojnë një praktikë profesionale të monitorimit të bazuar në prova. Ai kombinon qartësinë metodologjike me mjetet praktike, duke u mbështetur në standardet e programit “Bashki të Forta” dhe në të dhënat e Raportit të Performancës së Bashkive 2024.

Sistemi i Matjes së Performancës (SMP), i cili në vitin 2025 realizoi ciklin e tij të dytë, përbën një mekanizëm thelbësor për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Ky sistem është hartuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) me synimin për të avancuar performancën e qeverisjes vendore, në përputhje me Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin.

Publikimi i Raportit Kombëtar të Performancës së Bashkive nga AMVV, i cili përmbyll Fazën III në Nëntor 2025, ofron një panoramë të konsoliduar dhe të vërtetuar të performancës. Media mund ta përdorë këtë raport për të nxitur debate të informuara dhe të bazuara në fakte, duke evidentuar sukseset (stimulimi dhe promovimi i performancës së mirë) dhe dështimet (identifikimi i fushave ku nevojitet ndërhyrje apo mbështetje) e qeverisjes vendore, duke krijuar mundësi për rritjen e llogaridhënies së bashkive.

## QËLLIMI I MANUALIT

Ky manual synon të ofrojë një udhëzues të qartë dhe praktik për monitorimin e performancës së bashkive. Ai është ndërtuar për të ndihmuar gazetarët dhe OShCtë të përdorin të dhënat publike në mënyrë profesionale, të ndërtojnë histori hulumtuese me ndikim dhe të rrisin transparencën dhe llogaridhënien vendore.

### OBJEKTIVAT KRYESORË:



Kuptimi i  
kuadrit të  
performancës



Përdorimi i  
të dhënave  
publike



Monitorim i  
bazuar  
në prova



Gazetari  
hulumtuese



Advokim  
i bazuar  
në evidencë

## KUADRI I PERFORMANCËS VENDORE

Sistemi i Matjes së Performancës (SMP) ka për qëllim kryesor promovimin e një kulture përmirësimi të vazhdueshëm, vendimmarrjeje të bazuar në të dhëna, transparence dhe llogaridhënieje. Ky sistem orienton bashkitë drejt rezultateve të qarta dhe të matshme dhe shërben si një mjet reflektimi, duke ndihmuar bashkitë të identifikojnë fushat ku nevojitet ndërhyrje ose mbështetje.

Sistemi është i strukturuar në tri kategori kryesore:

**Shërbimet:** Përfshin gjashtë fusha, si Arsimi Parauniversitar, Menaxhimi i Mbetjeve dhe Mbrojtja Sociale.

**Mirëqeverisja:** Përfshin pesë fusha, si Burimet Njerëzore, Transparenca dhe Llogaridhënia, Barazia Gjinore dhe Integrimi në Bashkimin Evropian.

**Menaxhimi Financiar:** Mbulon Të Ardhurat, Buxhetin dhe Shpenzimet.

Këto kategori janë zbërthyer në 13 fusha prioritare me gjithsej 52 tregues të performancës që vlerësojnë ushtrimin e kompetencave bashkiake. Për çdo tregues, ky Manual për Sigurimin e Cilësisë së të Dhënave përcakton metodat e përlogaritjes, burimin, nivelin e disagregimit dhe procedurat e verifikimit, me qëllim prodhimin e të dhënave të sakta, të unifikuara dhe të besueshme.

Një element kyç i rëndësisë së SMP-së është lidhja e tij me Granti i Bazuar në Performancë (GBP). GBP është një instrument financiar incentivues që shpërndan fonde shtesë për bashkitë, bazuar në vlerësimin e performancës së tyre.

Njëkohësisht, ky kuadër performance ofron indikatorë të matshëm, dhe mundëson krahasime ndërmjet bashkive. Gjithashtu, identifikimi i problemeve strukturore përtej rasteve individuale, forcon besueshmërinë e raportimeve dhe advokimit.

## PROMOVIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Bazuar në të dhënat e Raportit të Performancës së Bashkive 2024 mund të evidentohen disa praktika të mira në nivel kombëtar, që mund të shërbejnë si shembull për bashkitë e tjera.

### PRAKTIKA

# 1

## Rritja e të ardhurave të veta për frymë

**Indikatori SMP:** Të ardhurat e veta për frymë

**Vlera kombëtare 2024:** 18,497 lekë/banorë

**Citimi:** “Në 2024, të ardhurat e veta për frymë rezultojnë në vlerën 18,497 lekë/banorë...”

**Pse është praktikë e mirë:** Rrit autonominë financiare. Ky progres tregon aftësi më të larta për të gjeneruar të ardhura vendore dhe për të mbështetur shërbimet publike me burime të qëndrueshme.

**Shembull bashkie:** Tirana, Durrësi, Korça.

### PRAKTIKA

# 2

## Ulja drastike e detyrimeve të prapambetura

**Indikatori SMP:** Detyrimet e prapambetura

**Citimi:** “Nga 12 miliardë lekë në 2015, në rreth 3.1 miliardë lekë në 2024.”

**Pse është praktikë e mirë:** Ky trend ul rrezikun financiar dhe rrit besueshmërinë e bashkive

**Shembull bashkie:** Shkodra, Vlora.

## Rritja e investimeve për frymë

**Indikatori SMP:** Investimet kapitale për frymë

**Citimi:** “Nga 3,773 lekë në 2015, në 6,376 lekë në 2024.”

**Pse është praktikë e mirë:** Përmirëson infrastrukturën dhe përkthehet në projekte më të mëdha dhe më cilësore në terren.

**Shembull bashkie:** Fieri, Elbasani.

## Përmirësim i arsimit parashkollor

**Indikatori SMP:** Raporti fëmijë-mësues, regjistrimet në çerdhe

**Citimi:** “Regjistrimet në çerdhe nga 10% në 2023 në 12.5% në 2024.”

**Pse është praktikë e mirë:** Përmirësimi i raportit fëmijëmësues dhe investimet në çerdhe e kopshte rrit aksesin në edukim.

**Shembull bashkie:** Korça.

## Rritja e funksionalitetit të sistemit ujitës-kullues

**Indikatori SMP:** Funksionaliteti i kanaleve

**Citimi:** “Një sistem kanalesh gati 6 herë më funksional sesa viti 2015.”

**Pse është praktikë e mirë:** Rrit prodhimin bujqësor. Sistemi i kanaleve ujitëse dhe kulluese është përmirësuar ndjeshëm, duke rritur produktivitetin bujqësor.

**Shembull bashkie:** Lushnja, Divjaka.

## PRAKTIKA

# 6

### Rritja e kapaciteteve të mbrojtjes nga zjarri

**Indikatori SMP:** Zjarrfikës për banor

**Citimi:** “Numri i zjarrfikësve është dyfishuar krahasuar me një dekadë më parë...”

**Pse është praktikë e mirë:** Siguria publike është forcuar falë rritjes së burimeve njerëzore dhe logjistike.

**Shembull bashkie:** Berati, Gjirokastra.

## PRAKTIKA

# 7

### Përmirësim i menaxhimit të mbetjeve

**Indikatori SMP:** Mbulimi i shërbimit

**Citimi:** “Mbulimi kombëtar i shërbimit është 85.6%... kosto e 1 ton mbetje urbane është ulur.”

**Pse është praktikë e mirë:** Shërbimi i pastrimit është zgjeruar dhe bërë më efikas.

**Shembull bashkie:** Pogradeci.

## PRAKTIKA

# 8

### Rritje e shpejtësisë së reagimit në shërbimet sociale

**Indikatori SMP:** Raste të shërbimit

**Citimi:** “Rastet e dhunës gjejnë zgjidhje shumë më shpejt...”

**Pse është praktikë e mirë:** Mbrojtja sociale është bërë më e shpejtë dhe më efektive për trajtimin e rasteve të emergjencës sociale.

**Shembull bashkie:** Tirana, Durrësi.

## Rritje e transparencës dhe qeverisjes së hapur

**Indikatori SMP:** Publikimi i dokumenteve

**Citimi:** “Viti 2024 përbën një pikë kthese në konsolidimin e qeverisjes së hapur...”

**Pse është praktikë e mirë:** Publikimi i dokumenteve dhe të dhënave ka hyrë në një fazë të re konsolidimi duke rritur llogaridhënien.

**Shembull bashkie:** Tirana, Shkodra, Vlora.

## Integrimi evropian në nivel bashkie

**Indikatori SMP:** Kapacitetet për projektet e BE-së

**Citimi:** “Për herë të parë, viti 2024 solli matjen e dimensionit të integritimit evropian...”

**Pse është praktikë e mirë:** Rrit aftësinë për fonde BE. Për herë të parë, bashkitë janë vlerësuar për kapacitetet e tyre në projektet e BE-së.

**Shembull bashkie:** Elbasani, Korça.

## METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i bazuar në prova kërkon disiplinë metodologjike. Pyetja hulumtuese duhet të jetë e qartë dhe e matshme. Të dhënat duhet të mblidhen nga burime të ndryshme dhe të verifikohen me kujdes. Raportimi duhet të jetë i qartë, i balancuar dhe i orientuar drejt qytetarëve.



### HAPI

# 1

## Përcakto pyetjen hulumtuese

### Shembuj:

- “Si ka ndryshuar performanca e pastrimit në bashki gjatë 3 viteve të fundit?”
- “A ka rritje të kostos së shërbimeve pa rritje të cilësisë?”
- “A janë zbatuar konsultimet publike sipas ligjit?”

## HAPI

# 2

### Mblidh të dhënat

- Dokumente zyrtare
- Intervista me zyrtarë
- Intervista me qytetarë
- Vëzhgim në terren
- Krahasime me bashki të tjera

## HAPI

# 3

### Analizo

- Identifiko trendet
- Krahaso planin me realizimin
- Shiko mospërputhjet
- Gjej indikatorë të dobët ose të fortë

## HAPI

# 4

### Verifiko

- Kontrolllo burime të pavarura
- Pyet ekspertë
- Kërko dokumente shtesë nëse ka boshllëqe

## Raporto qartë

- Përdor grafikë të thjeshtë
- Shpjego termat teknikë
- Vendos burimet
- Fokusohu te ndikimi te qytetarët

### Rasti studimor

Gazetaria hulumtuese në nivel vendor është një mjet i fuqishëm për të zbuluar probleme strukturore, për të nxjerrë në pah mospërputhje dhe për të kërkuar llogari nga institucionet.



#### **Rast studimor (nga Raporti 2024):**

Në disa bashki, kostot e pastrimit janë rritur me 12%, ndërkohë që mbulimi rural ka mbetur vetëm 65%. Kjo mospërputhje është një pikënisje ideale për një investigim.

## Si të identifikosh një histori të fortë

- Shifra që nuk përputhen
- Shërbime që nuk funksionojnë
- Prokurime të dyshimta
- Projekte të papërfunduara
- Vendime pa konsultim publik

## Si të strukturosh një investigim

- Problemi
- Provat
- Kush është përgjegjës
- Kush ndikohet
- Çfarë thotë ligji
- Çfarë duhet të ndodhë më tej

## Etika dhe siguria

- Verifikim i dyfishtë i burimeve
- Mbrojtja e burimeve konfidenciale
- Shmangia e gjuhës së paragjykitimit
- Raportim i balancuar

## MJETET PRAKTIKE PËR OSHC-TË

### HAPI

# 1

### Monitorim i shërbimeve publike

- Fletë-vlerësime për qytetarët
- Vëzhgime në terren
- Raporte mujore të shkurtuara
- Evidentim i praktikave të mira

### HAPI

# 2

### Advokim i bazuar në prova

- Përdor grafikë të thjeshtë
- Përgatit mesazhe të qarta
- Përdor shembuj konkretë
- Bashkëpunohet me media locale

## FORMATE TË GATSHME PËR INFORMIM

Ky kapitull ofron një paketë të standardizuar formash praktike për kërkesa për informacion për gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë me monitorim të shërbimeve publike, gazetari hulumtuese dhe advokim të bazuar në prova. Formatet janë përshtatur sipas praktikave ligjore në fuqi për të drejtën e informimit si dhe praktikës së monitorimit të “Bashki të Forta” dhe pasuruar me shembuj nga Raporti i Performancës së Bashkive 2024.

### FORMATI

# 1

## Kërkesë për Informacion

[Sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”]

### Subjekti: Kërkesë për informacion mbi performancën e bashkisë

Për: [Emri i Bashkisë / Institucionit] Koordinatori për të Drejtën e Informimit  
I nderuar/e,

Në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju kërkoj të më vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm:

- 1 Raportet e performancës së bashkisë për vitin 2023–2024.
- 2 Të dhënat mbi shërbimin e pastrimit [kontrata, kostot, mbulimi rural/urban].
- 3 Të dhënat mbi shërbimet sociale [numri i përfituesve, buxheti, llojet e shërbimeve].
- 4 Dokumentet e prokurimeve publike për shërbimet e decentralizuara.
- 5 Treguesit financiarë: të ardhurat e veta, detyrimet e prapambetura, investimet kapitale.

Ju lutem që informacioni të ofrohet në format elektronik.

Me respekt, [Emri] [Organizata/Media] [Kontakti] [Data]

Shembull konkret [Raporti 2024]:

Nëse një OShC kërkon të analizojë pse Bashkia X ka vetëm 65% mbulim rural të pastrimit, kjo kërkesë i jep akses në kontrata, raporte mujore dhe të dhëna financiare.

## Monitorimi i Shërbimit të Pastrimit në Bashkinë [X] – Janar–Qershor 2024

### 1 Përmbledhje Ekzekutive

- ◆ Qëllimi: Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të pastrimit.
- ◆ Metodologjia: Dokumente zyrtare, vëzhgim në terren, intervista.
- ◆ Gjetjet: Mbulimi rural 65%, kosto +12%, mospërputhje me kontratën.
- ◆ Rekomandimet: Rritje e monitorimit, transparencë më e madhe, auditim i kontratës.

### 2 Konteksti

Sipas Raportit të Performancës 2024, disa bashki mbledhin më shumë të ardhura sesa shpenzojnë realisht për shërbimin e pastrimit, duke krijuar boshllëqe në cilësi dhe mbulim.

### 3 Metodologjia

- ◆ Dokumente: kontrata, raportet mujore, buxheti.
- ◆ Terren: 20 pika monitorimi.
- ◆ Intervista: 15 qytetarë, 2 zyrtarë.
- ◆ Kufizime: mungesë të dhënash të detajuara për zonat rurale.

### 4 Gjetjet Kryesore

#### 4.1. Treguesit e Performancës

- ◆ Frekuenca e mbledhjes: 3 herë/javë në qendër, 1 herë/javë në fshatra.
- ◆ Mbulimi rural: 65% [standard minimal i rekomanduar: 80%].
- ◆ Kosto për ton: +12% krahasuar me 2023.

#### 4.2. Mospërputhjet

- Kontrata parashikon mbulim 80% rural, por realizimi është 65%.

#### 4.3. Praktikrat e Mira

- Disa bashki në Shqipëri dhe Mesme kanë standard të qëndrueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj ankesave.

### 5 Analiza

- ◆ Krahasim me bashki të tjera: Bashkia Y ka 78% mbulim rural me kosto më të ulët.
- ◆ Ndikimi te qytetarët: rritje e ankesave me 30%.

### 6 Rekomandime

- ◆ Rritje e monitorimit të kontratës.
- ◆ Investime në logjistikë për zonat rurale.
- ◆ Publikim mujor i treguesve të performancës.

## Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë X: Kosto në Rritje, Cilësi në Rënie

Në vitin 2024, Bashkia X ka rritur buxhetin e pastrimit me 12%, ndërkohë që mbulimi rural ka mbetur vetëm 65%. Ky investigim analizon arsyet e kësaj mospërputhjeje.

### 1 Çfarë kemi zbuluar

- ◆ Kontrata parashikon mbulim 80%, por realizimi është 65%.
- ◆ Kosto për ton është rritur pa justifikim teknik.
- ◆ Raportet mujore nuk përputhen me vëzhgimet në terren..

### 2 Si e zbuluam

- ◆ Analizë e kontratës dhe raporteve të bashkisë.
- ◆ Vëzhgim në 20 pika monitorimi.
- ◆ Intervista me banorë dhe zyrtarë.

### 3 Kush është përgjegjës

- ◆ Operator privat i kontraktuar.
- ◆ Drejtoria e shërbimeve publike.

### 4 Si ndikon te qytetarët

- ◆ Rritje e ndotjes në zonat rurale.
- ◆ Ankesat janë rritur me 30%.

### 5 Çfarë thonë palët

- ◆ Bashkia: "Operatori ka pasur vështirësi logjistike."
- ◆ Qytetarët: "Kamionët nuk vijnë sipas orarit."
- ◆ Ekspertët: "Mungon monitorimi i performancës."

### 6 Çfarë duhet të ndodhë më tej

- ◆ Auditim i kontratës.
- ◆ Vendosja e treguesve të matshëm.
- ◆ Publikim i të dhënave mujore.

## Përmirësimi i mbulimit të pastrimit në zonat rurale të bashkisë X

Në vitin 2024, Bashkia X ka rritur buxhetin e pastrimit me 12%, ndërkohë që mbulimi rural ka mbetur vetëm 65%. Ky investigim analizon arsyet e kësaj mospërputhjeje.

### 1 Përmbledhje Ekzekutive

Në vitin 2024, mbulimi rural i pastrimit në Bashkinë X është vetëm 65%, nën standardin minimal të rekomanduar prej 80%. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

### 2 Problemi

- ◆ Mospërputhje midis kontratës dhe zbatimit.
- ◆ Rritje e kostove pa rritje të cilësisë.
- ◆ Pabarazi të forta urban-rural.

### 3 Analiza e Provave

- ◆ Treguesit e performancës 2024 tregojnë se mbulimi rural është nën standard.
- ◆ Kostot janë rritur me 12% pa justifikim teknik.
- ◆ Bashkitë e ngjashme arrijnë mbulim 75-80% me kosto më të ulët.

### 4 Opsionet e Politikave

- ◆ Opsioni A: Rritje e kapaciteteve të monitorimit të kontratës.
- ◆ Opsioni B: Rishikim i kontratës dhe vendosja e treguesve të detyrueshëm.
- ◆ Opsioni C: Investime në logjistikë për zonat rurale.

### 5 Rekomandimi i Preferuar

Opsioni B: Rishikim i kontratës dhe vendosja e treguesve të detyrueshëm të performancës, pasi ofron ndikimin më të shpejtë dhe më të matshëm.

### 6 Hapat e Zbatimit

- ◆ Muaji 1: Auditimi i kontratës.
- ◆ Muaji 2: Vendosja e treguesve të rinj.
- ◆ Muaji 3-6: Monitorim mujor dhe publikim i rezultateve.

## LISTA E KONTROLLIT

A e kam pyetjen  
hulumtuese të qartë?

1

2

A kam mbledhur të dhëna  
nga të paktën 3 burime?

A kam verifikuar  
çdo pretendim?

3

4

A kam krahasuar me vite të  
tjera ose bashki të tjera?

A kam shpjeguar ndikimin  
te qytetarët?

5

6

A kam përdorur gjuhë të  
thjeshtë dhe të kuptueshme?

## REFERENCA

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Link: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139>

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Link [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Ligj-nr.119-date-18.9.2014\\_ndryshuar-2.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Ligj-nr.119-date-18.9.2014_ndryshuar-2.pdf)

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS TË BASHKIVE 2024, <https://bashkiteforta.al/sistemi-i-matjes-se-performances-te-bashkive-2024/>

Udhëzues i përshtatur i sistemit të matjes së performancës së bashkive

## KATEGORIA

# 1

## Shërbimet

Kjo kategori mat ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve.

Kategoria e Shërbimeve është thelbësore, pasi vlerëson drejtpërdrejt ofrimin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV, ofrojnë për qytetarët. Kjo kategori është zbrërthyer në gjashtë fusha prioritare,, ku bashkitë përcaktojnë rezultate specifike që maten përmes treguesve cilësorë dhe sasiorë. Qëllimi është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve dhe menaxhimit.

Gjashtë fushat brenda Kategorisë "Shërbimet" janë:

# 1

## FUSHA

## Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat e bashkive në këtë fushë rregullohen nga Ligji nr. 139/2015, duke përfshirë dy funksione kryesore: ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore (Funksioni 23.11), dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe (Funksioni 23.12),. Bashkitë janë përgjegjëse si për aspektet infrastrukturore, ashtu edhe për ato menaxheriale të institucioneve arsimore.

### TREGUESIT MATËS MONITOROJNË:

- ◆ **Aksesi dhe Pjesëmarrja:** Shkallën e Regjistrimit në Çerdhe [A01] dhe Kopshte [A02],.
- ◆ **Cilësia dhe Kapaciteti:** Raporti Fëmijë-Mësues [A03], ku një raport i ulët tregon më shumë cilësi në ofrimin e edukimit, si dhe Numri i Godinave Arsimore [A04],.
- ◆ **Planifikimi Strategjik:** Ekzistenca dhe zbatimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar [A05],. Ky tregues cilësor është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## 2

### FUSHA

### Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit

Ky funksion është një kompetencë e deleguar e NJVV-ve dhe synon mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe menaxhimin e ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

### TREGUESIT MATËS VLERËSOJNË:

- ◆ **Mbulimi:** Toka Bujqësore e Pajisur me Kanale Ujitje/Kullimi [B01], e cila mat sipërfaqen e tokës bujqësore të mbuluar me sisteme funksionale,.
- ◆ **Funksionaliteti:** Përqindja e Kanaleve Funksionale të Ujitjes dhe Kullimit [B02], e cila vlerëson gjatësinë e rrjeteve që janë aktualisht në gjendje pune.

## 3

### FUSHA

### Pyjet dhe Kullotat

Menaxhimi i kësaj fushe i është deleguar bashkive për administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kulloror publik brenda territorit të tyre.

### TREGUESIT MATËS VLERËSOJNË:

- ◆ **Planifikimi Strategjik:** Shkalla e Pajisjes me Plane Mbarështimi [P01], e cila mat përmasën e fondit të mbuluar nga plane mbarështimi të miratuara. Ky është një tregues GBP.

- ◆ **Kapaciteti Njerëzor:** Punonjës për 1,000 Hektarë [P02], i cili mat burimet njerëzore të dedikuara për administrimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve.

## 4

### FUSHA

## Mbrojtja nga Zjarri (MZSH)

Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrfikës, duke përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrfikëse, si dhe organizimin e shërbimeve parandaluese.

### TREGUESIT MATËS VLERËSOJNË:

- ◆ **Personeli:** Zjarrfikës për 1,500 banorë [Z01], i cili mat përputhshmërinë me standardin ligjor për mbulimin me punonjës zjarrfikës.
- ◆ **Logjistika:** Automjete Zjarrfikëse për 10,000 Banorë [Z02], i cili reflekton aftësinë logjistike me mjete funksionale.

## 5

### FUSHA

## Menaxhimi i Mbetjeve (MIM)

Ky funksion përfshin menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë mbledhjen, transportin, trajtimin dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

### TREGUESIT MATËS VLERËSOJNË:

- ◆ **Akresi dhe Efikasiteti:** Mbulimi i Popullsisë me Shërbim [M01] dhe Mbetjet e Gjeneruara si Kg/Banor [M02],.
- ◆ **Qëndrueshmëria Financiare:** Mbulimi i Kostos së Menaxhimit të Mbetjeve nga Tarifa e Shërbimit [M03], i cili mat përqindjen e kostove të mbuluara nga të ardhurat e mbledhura.
- ◆ **Planifikimi:** Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve [M04], i cili vlerëson gjendjen e planit strategjik, një tregues thelbësor për GBP.

## 6

### FUSHA

## Mbrojtja Sociale

Kjo fushë përfshin përgjegjësinë e bashkive për ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale për individët dhe familjet në nevojë, si ndihma ekonomike, strehimi social dhe funksionimi i qendrave sociale.

### TREGUESIT MATËS VLERËSOJNË:

- ◆ **Aksesi në Mbështetje:** Përqindja e Familjeve që Marrën Ndhimë Ekonomike [S01] dhe Shkalla e Miratimit të Strehimit Social [S02].
- ◆ **Infrastruktura Sociale:** Numri i Qendrave Sociale Komunitare Publike, të Licencuara për 10,000 Banorë [S03], duke përfshirë qendrat ditore dhe rezidenciale.
- ◆ **Mbrojtja e Grupeve Vulnerabël:** Përqindja e Rasteve të Referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit [MKR] [S04] dhe Personave me Aftësi të Kufizuar [PAK] [S05] që marrin shërbime sociale të integruara,.
- ◆ **Planifikimi Social:** Ekzistenca dhe zbatimi i Planit Vendor Social [S06], një tregues i cili është pjesë e kritereve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Në Seksionin më poshte detajohen treguesit dhe të dhënat që janë përdorur për përlogaritjen e tyre.

## 7

### FUSHA

## Arsimi parauniversitar

Kjo fushë përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore, si dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor (kopshte dhe çerdhe).

**Treguesi A01:** Shkalla e Regjistrimit në Çerdhe [Mat nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve 6 muaj–3 vjeç në çerdhet publike].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ A01.1: Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj–3 vjeç në bashki.
- ◆ A01.2: Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike.

**Treguesi A02:** Shkalla e Regjistrimit në Kopshte Publike dhe Private [Reflekton përfshirjen e fëmijëve 3–6 vjeç në arsimin parashkollor].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ A02.1: Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki.
- ◆ A02.2: Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike.
- ◆ A02.3: Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private.

**Treguesi A03:** Raporti Fëmijë–Mësues në Kopshte Publike dhe Private [Vlerëson numrin mesatar të fëmijëve për edukator/e, ku një raport i ulët sugjeron cilësi më të lartë].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ A02.2: Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet publike [3–6 vjeç].
- ◆ A02.3: Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet private [3–6 vjeç].
- ◆ A03.1: Numri i edukatorëve në kopshte publike.
- ◆ A03.2: Numri i edukatorëve në kopshte private.

**Treguesi A05:** Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar [Vlerëson planifikimin strategjik].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ A05.1: Plani i Arsimit Parauniversitar i miratuar gjatë vitit të raportimit [Po/Jo].
- ◆ A05.2: Periudha e miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar [Muaj/Vit].
- ◆ A05.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit të Arsimit Parauniversitar [Numër muajsh].

Ky tregues është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## 8

### FUSHA

## Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Funksioni synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe menaxhimin e ujërave të tepërta.

**Treguesi B01:** Tokë Bujqësore e Pajisur me Kanale Ujitje / Kullimi [Mat sipërfaqen e tokës bujqësore të mbuluar me sisteme ujitjeje dhe kullimi].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ B01.1: Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki [Hektarë ose km<sup>2</sup>].
- ◆ B01.2: Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi [Hektarë ose km<sup>2</sup>].

**Treguesi B02:** Përqindja e Kanaleve Funktionale të Ujitjes dhe Kullimit [Mat infrastrukturën funksionale].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ B02.1: Gjatësia e kanaleve ujitëse [km ose m].
- ◆ B02.2: Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale [km ose m].
- ◆ B02.3: Gjatësia e kanaleve kulluese [km ose m].
- ◆ B02.4: Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale [km ose m].

## 9

### FUSHA

## Pyjet dhe kullotat

Ky funksion përfshin administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik.

**Treguesi P01:** Shkalla e Pajisjes me Plane Mbarështimi [Mat fondin e mbuluar nga plane mbarështimi të miratuara, duke reflektuar planifikimin strategjik].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ P01.1: Plan Mbarështimi i miratuar gjatë vitit të raportimit [Po/Jo].
- ◆ P01.4: Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullor në bashki [ha/km].
- ◆ P01.5: Sipërfaqja e fondit Pyjor dhe Kullor e mbuluar me Plan Mbarështimi [ha/km].

Ky tregues është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

**Treguesi P02:** Punonjës për 1,000 Hektarë [Vlerëson burimet njerëzore të dedikuara për menaxhimin e fondit].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ P01.4: Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullësor në bashki.
- ◆ P02.1: Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor [punonjës të përhershëm ose të përkohshëm].

## **10** FUSHA **Mbrojtja nga zjarri (mzsh)**

Kjo fushë mat kapacitetin njerëzor dhe logjistik për t'u siguruar reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash.

**Treguesi Z01:** Zjarrëfikës për 1,500 banorë [Mat nivelin e përputhshmërisë me standardin ligjor për stafin zjarrëfikës].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ Z01.1: Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki [të punësuar me kohë të plotë].
- ◆ Numri i popullsisë banuese në bashki.

**Treguesi Z02:** Automjete Zjarrëfikëse për 10,000 Banorë [Reflekton aftësinë logjistike të bashkive].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ Z02.1: Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki.
- ◆ Numri i popullsisë banuese në bashki.



Përfshin mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitim të mbetjeve urbane, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

**Treguesi M01:** Mbulimi i Popullsisë me Shërbimin e Menaxhimit të Mbetjeve në Zonat Urbane/Rurale [Mat përqindjen e popullsisë së mbuluar nga shërbimi].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ M01.1: Numri i Njësive Administrative qendër [qytetet] të mbuluar me shërbimin e mbetjeve.
- ◆ M01.2: Numri i fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve.
- ◆ Numri i fshatrave në territorin e bashkisë.
- ◆ Numri i qendrave së Njësive Administrative.

**Treguesi M02:** Mbetjet e Gjeneruara si Kg/Banor [Mat sasinë mesatare të mbetjeve të prodhuara nga një banor në vit].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ M02.1: Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej [kg].
- ◆ Numri i popullsisë banuese në bashki.

**Treguesi M03:** Mbulimi i Kostos së Menaxhimit të Mbetjeve nga Tarifa e Shërbimit [Mat përqindjen e kostove të shërbimit të mbetjeve të mbuluara nga të ardhurat e tarifës].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ M03.1: Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve [Mijë lekë].
- ◆ Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve [Mijë lekë].

**Treguesi M04:** Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve [Mat gjendjen e Planit Vendor [miratim ose zbatim]].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ M04.1: Plani i miratuar gjatë vitit të raportimit [Po/Jo].
- ◆ M04.2: Periudha e miratimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve [Muaj/Vit].
- ◆ M04.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit të Menaxhimit të Mbetjeve [Numër muajsh].

Ky tregues është pjesë e kritereve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## 12 FUSHA Mbrojtja sociale

Ky funksion përfshin ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale për individët dhe familjet në nevojë.

**Treguesi S01:** Përqindja e Familjeve që Marrën Ndhmë Ekonomike [NE] [Vlerëson mbulimin me skemën e Ndhmës Ekonomike].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S01.1: Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike.
- ◆ S01.2: Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

**Treguesi S02:** Shkalla e Miratimit të Strehimit Social [Mat shkallën e miratimit të aplikimeve për strehim social].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S02.1: Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social.
- ◆ S02.2: Numri i personave përfitues të strehimit social [me vendim të KB].

**Treguesi S03:** Numri i Qendrave Sociale Komunitare Publike, të Licencuara Për 10,000 Banorë [Mat aksesin në qendrat sociale ditore dhe rezidenciale].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S03.1: Numri i qendrave sociale ditore funksionale, të licencuara.
- ◆ S03.2: Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale, të licencuara.
- ◆ Numri i popullsisë banuese në bashki.

**Treguesi S04:** Raste të Referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit [MKR] që Përfitojnë Shërbime Sociale [Mat efikasitetin e ndjekjes institucionale të rasteve të dhunës në familje].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S04.1: Numri i rasteve të dhunës në familje të referuara nga MKR.
- ◆ S04.2: Numri i rasteve të referuara nga MKR, të cilat kanë përfituar shërbime sociale.

**Treguesi S05:** Përqindja e Personave me Aftësi të Kufizuar [PAK], të Referuar nga Komisionet Bio-Psiko-Sociale, që Marrën Mbështetje Sociale të Integruara [Mat aksesin e PAK-ve pas referimit nga komisionet].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S05.1: Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale.
- ◆ S05.2: Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit.

**Treguesi S06:** Plan Vendor Social [Vlerëson ekzistencën dhe zbatimin e dokumentit strategjik për menaxhimin e shërbimeve sociale].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ S06.1: Plani Vendor Social, i miratuar gjatë periudhës së raportimit [Po/Jo].
- ◆ S06.2: Periudha e miratimit të Planit Social Vendor [Muaj/Vit].
- ◆ S06.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit Social Vendor [Numër muajsh].

Ky tregues është pjesë e kritereve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## KATEGORIA

# 2

## Mirëqeverisja

Kategoria e Mirëqeverisjes në Sistemin e Matjes së Performancës (SMP) vlerëson efikasitetin administrativ, llogaridhënie institucionale, transparencën dhe angazhimin strategjik të bashkive. E ndërtuar për të promovuar një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm dhe vendimmarrjeje të bazuar në të dhëna, kjo kategori përmban katër fusha kryesore që vlerësojnë elementë të ndryshëm të funksionimit të brendshëm dhe angazhimeve strategjike.

# 1

## FUSHA

## Burimet Njerëzore

Kjo fushë mat rolin e rëndësishëm të bashkive në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Qëllimi kryesor është të sigurohet një trupë administrative efektive dhe e kualifikuar e aftë për të ofruar shërbime publike.

- ◆ **Përshkrimi:** Menaxhimi i Burimeve Njerezore përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, duke ndjekur dinamikat e personelit si rotacioni, rekrutimi dhe trajnimi.
- ◆ **Vlerësimi Fokusohet te:** Shkalla e rotacionit të punonjësve [NJ01] dhe përqindja e stafit të trajnuar [NJ02], duke synuar përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve të stafit. Bashkia ndjek gjithashtu numrin e punonjësve për 1,000 banorë [NJ03].

## 2

### FUSHA

## Transparenca dhe Llogaridhënia

Kjo fushë mat zbatimin e parimeve themelore të qeverisjes së mirë, duke garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve, publikimin e informacionit dhe dhënien e llogarisë.

- ◆ **Përshkrimi:** Bashkitë kanë detyrimin të zhvillojnë konsultime publike për akte me ndikim në komunitet, të publikojnë dokumentet e rëndësishme [si Raporti Vjetor i Transparencës], dhe të hartojnë e zbatojnë plane integriteti për të forcuar etikën institucionale.
- ◆ **Vlerësimi Fokusohet te:** Pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës [T01], publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës [T02] dhe ekzistenca e Planit Vendor të Integritetit [T03]. Zbatimi i Planit të Integritetit është një kriter i vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## 3

### FUSHA

## Barazia Gjinore (BGJ)

Kjo fushë vlerëson nëse bashkia po ndërton institucione demokratike dhe gjithëpërfshirëse duke garantuar balancën e përfaqësimit dhe duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse.

- ◆ **Përshkrimi:** Bashkitë duhet të garantojnë pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe të sigurojnë ofrimin e shërbimeve që adresojnë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.
- ◆ **Vlerësimi Fokusohet te:** Përfaqësimi gjinor në pozicionet kyçe [GJ01], si Kryetare, Zv.Kryetare dhe Anëtare të Këshillit Bashkiak, dhe përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme brenda administratës [GJ02].

Gjithashtu vlerësohet institucionalizimi i BGJ përmes Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore [GJ03], i cili është tregues GBP.

## 4

### FUSHA

## Integrimi në Bashkimin Evropian

Kjo fushë vlerëson angazhimin e NJVV-ve në procesin e integrimit evropian, duke qenë se ky proces përfshin të gjitha nivelet e administratës.

- ◆ **Përshkrimi:** Bashkitë duhet të ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e Bashkimit Evropian [BE], si dhe të fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës dhe pjesëmarrjes.
- ◆ **Vlerësimi Fokusohet te:** Rritja e bashkëpunimit ndërbashkiak përmes Marrëveshjeve Ndërbashkiake [I01], shkalla e suksesit në aksesimin e fondeve të BE-së, e matur përmes Projekteve të Fituara kundrejt të Aplikuara [I03], dhe ekzistenca e Planit Vendor të Migracionit dhe Diasporës [I04]. Gjithashtu, monitorohet funksionimi i Komisioneve të Integrimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë [I05].

Këto fusha, së bashku, sigurojnë që menaxhimi i performancës së bashkive të mos fokusohet vetëm në shërbimet e jashtme, por edhe në cilësinë e qeverisjes së brendshme, e cila është thelbësore për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit institucional të qeverisjes vendore.

## 5

### FUSHA

## Burimet njerëzore

Kjo fushë përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, duke synuar një trupë administrative efektive.

**Treguesi NJ01:** Shkalla e Rotacionit të Punonjësve të Bashkisë [Mat lëvizjen e stafit gjatë një viti].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ NJ01.1: Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit [administratë dhe njësi shpenzuese].

- ◆ NJ01.2: Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit.

**Treguesi NJ02:** Përqindja e Stafit të Punësuar nga Bashkia të Trajnuar [Mat pjesëmarrjen e stafit në trajnime].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ NJ01.1: Numri i punonjësve në bashki.
- ◆ NJ02.1: Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit.

**Treguesi NJ03:** Punonjës Për 1,000 Banorë [Mat ngarkesën e stafit në raport me popullsinë].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ NJ03.1: Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara.
- ◆ NJ01.1: Numri i punonjësve në bashki.
- ◆ Numri i popullsisë banuese në bashki.

## 6

### FUSHA

## Transparenca dhe llogaridhënia

Kjo fushë mat zbatimin e detyrimeve ligjore për konsultimin me publikun dhe transparencën e vendimmarrjes.

**Treguesi T01:** Akte për të Cilët është i Detyrueshëm Zhvillimi i Konsultimit Publik [Mat përqindjen e akteve të konsultuara].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ T01.1: Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik.
- ◆ T01.2: Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik [me dokumentim të plotë].

**Treguesi T02:** Raporti Vjetor për Transparencën në Procesin e Vendimmarrjes [Mat nëse është përmbushur detyrimi ligjor për publikimin e raportit].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ T02.1: Publikimi i raportit vjetor për transparencën [Po/Jo].
- ◆ Treguesi T03: Plan Vendor i Integritetit [Vlerëson miratimin dhe zbatimin e planit për forcimin e etikës institucionale].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ T03.1: Plani Vendor i Integritetit, i miratuar gjatë periudhës së raportimit [Po/Jo].
- ◆ T03.2: Plan Vendor i Integritetit në zbatim [Muaj/Vit, kur miratimi është kryer më herët].
- ◆ T03.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit të Integritetit [Numër].

Ky tregues është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## **7 FUSHA** Barazia gjinore

Kjo fushë mat pjesëmarrjen e barabartë gjinore në vendimmarrje dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat vendore.

**Treguesi GJ01:** Përqindja e Grave në Pozicione: Kryetare, Zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore [Mat përfaqësimin gjinor në nivel të lartë vendimmarrës].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ GJ01.1: Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese kyçe [Kryetar/Zv.Kryetar, Administrator/e, Anëtarë KB].
- ◆ GJ01.2: Numri i grave në pozicione drejtuese [Kryetare, Zv.Kryetare, Administratore, Anëtare KB].

**Treguesi GJ02:** Përqindja e Grave në Pozicione Drejtuese të Ndryshme [të Lartë, të Mesme, të Ulët] në Bashki [Evidenton pjesëmarrjen në pozicionet menaxheriale/profesionale].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ GJ02.1: Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme [drejtorie, sektori, etj.].
- ◆ GJ02.2: Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme.

**Treguesi GJ03:** Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore [Mat institucionalizimin e BGJ përmes planeve të dedikuara].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ GJ03.1: Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar gjatë periudhës së raportimit [Po/Jo].

- ◆ GJ03.2: Periudha e Miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore [Muaj/Vit].
- ◆ GJ03.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit Vendor për Veprimit për Barazinë Gjinore [Numër muajsh].

Ky tregues është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë [GBP].

## 8

### FUSHA

## Integrimi në bashkimin evropian

Bashkitë luajnë rol kritik në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe në menaxhimin e fondeve të BE-së.

**Treguesi I01:** Numri i Marrëveshjeve Ndërbashkiake të Nënshkuara nga Secila Bashki [Vlerëson bashkëpunimin ndërmjet bashkive].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ I01.1: Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkuara.

**Treguesi I03:** Projekte të Fituara kundrejt të Aplikuara nga Bashkimi Evropian [Periudha 2-Vjeçare 2023-2024] [Mat shkallën e suksesit në aksesimin e fondeve të BE-së].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ I03.1: Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës 2023-2024.
- ◆ I03.2: Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës 2023-2024.

**Treguesi I04:** Planet e Migracionit dhe Diasporës [Vlerëson planifikimin strategjik për migracionin dhe diasporën].

Të Dhënat e Kërkuara:

- ◆ I04.1: Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar gjatë periudhës së raportimit [Po/Jo].
- ◆ I04.2: Periudha e Miratimit të Planit të Migracionit dhe Diasporës [Muaj/Vit].
- ◆ I04.3: Periudha e vlefshmërisë së Planit të Migracionit dhe Diasporës [Numër muajsh].

Menaxhimi Financiar përbën kategorinë e tretë dhe kyçe të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP). Ky funksion është thelbësor për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore, duke përfshirë planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, duke përfshirë Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Të dhënat dhe treguesit e kësaj kategorie sigurohen nga Ministria e Financës (MF), dhe për këtë arsye, manuali nuk jep të dhëna specifike të kërkuara (si S01.1 apo S02.1) apo formula llogaritëse brenda fushave të kësaj kategorie. Kjo kategori ndahet në tri fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: Të Ardhurat, Buxheti dhe Shpenzimet. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Shumica e treguesve të kësaj kategorie janë pjesë e kritereve të vlerësimit për Granti i Bazuar në Performancë (GBP), duke i bërë ato thelbësore për përfitimin nga transfertat financiare.

## 1

## FUSHA

## Të ardhurat

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta dhe atyre të transferuara. Analiza e të ardhurave kontribuon në kuptimin e varësisë së bashkisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale.

**Përshkrimi:** E drejta e bashkive për të mbledhur të ardhura buron nga neni 11 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Treguesit Kryesorë (F01-F05):** Matin raportin e të ardhurave të veta për frymë (F01), raportin e të ardhurave të veta përkundrejt transfertave (F02), raportin e të ardhurave të veta ndaj buxhetit (F03), shkallën e përdorimit të të ardhurave (F04), dhe të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore (F05).

## 2

### FUSHA

## Buxheti

Fusha e buxhetit fokusohet në procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor bashkiak, si dhe në përputhshmërinë me ciklin buxhetor.

**Përshkrimi:** Procesi i planifikimit dhe miratimit të buxhetit lokal rregullohet nga Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Treguesit Kryesorë (F06–F07):** Kjo fushë mat Buxhetin për frymë (F06) dhe Shkallën e ekzekutimit të buxhetit (F07), duke vlerësuar zbatimin e buxhetit fakt kundrejt planit.

## 3

### FUSHA

## Shpenzime

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive. Ajo vlerëson nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente për të përmbushur funksionet ligjore të bashkisë.

**Përshkrimi:** Bashkitë janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve publike vendore, në përputhje me Ligjin nr. 68/2017.

**Treguesit Kryesorë (F08–F12):** Treguesit matës përfshijnë Investimet për frymë (F08), Pesha e investimeve në buxhet (F09), si dhe Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve (F10), Pesha e personelit në buxhet (F11) dhe Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet (F12). Këta tregues janë të gjithë pjesë e kriterëve të vlerësimit për GBP.

## 4

### FUSHA

## Të ardhurat

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe të diversifikuara, duke kontribuar në kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale.

**Treguesi F01:** Të Ardhurat e Veta Për Frymë në Lekë [Mat raportin e të ardhurave të veta ndaj numrit të popullsisë].

**Treguesi F02:** Të Ardhurat e Veta Përkundrejt Transfertave [Vlerëson shkallën e varësisë së bashkisë nga transfertat e qeverisë qendrore].

**Treguesi F03:** Raporti i Të Ardhurave Të Veta Ndaj Buxhetit [Mat peshën e të ardhurave të gjeneruara nga bashkia në totalin e buxhetit].

**Treguesi F04:** Shkalla e Përdorimit të Të Ardhurave [Vlerëson efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave, fakt kundrejt planit].

**Treguesi F05:** Të Ardhurat nga Taksa e Pasurisë në Raport me Të Ardhurat Vendore [Mat peshën e të ardhurave të grumbulluara nga taksa e pasurisë në totalin e të ardhurave vendore].

## 5 FUSHA Buxheti

Kjo fushë fokusohet në procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor bashkiak, si dhe në përputhshmërinë me ciklin buxhetor.

**Treguesi F06:** Buxheti Për Frymë [Në Lekë] [Vlerëson madhësinë e buxhetit të bashkisë në raport me numrin e popullsisë].

**Treguesi F07:** Shkalla e Ekzekutimit Të Buxhetit: Fakt Përkundrejt Plan [Mat efikasitetin e zbatimit të buxhetit, duke krahasuar shpenzimet e realizuara me ato të planifikuara].

## 6 FUSHA Shpenzime

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive, duke vlerësuar nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente për të përmbushur funksionet ligjore.

**Treguesi F08:** Investime Për Frymë [Në Lekë] [Mat shpenzimet e kapitalit në raport me numrin e popullsisë].

**Treguesi F09:** Pesha e Investimeve në Buxhet [Mat përqindjen e shpenzimeve të kapitalit në totalin e buxhetit].

**Treguesi F10:** Pesha e Detyrimeve Financiare Të Papaguara Ndaj Të Tretëve [%] [Vlerëson shkallën e detyrimeve të bashkisë kundrejt totalit të tyre, si tregues i menaxhimit të borxhit].

**Treguesi F11:** Pesha e Personelit në Buxhet [Mat shpenzimet për paga dhe staf në totalin e buxhetit].

**Treguesi F12:** Pesha e Shpenzimeve Operacionale në Buxhet [Mat shpenzimet e përditshme administrative dhe operacionale në totalin e buxhetit].



